



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Datë 17.09.2019

Drejtuar: Operatorit ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k
Adresa: Bulevardi Zhan D'ark, Nd.32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1, Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

* * *

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur”

Referenca e procedurës: REF-31797-07-26-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Përmirësim i infrastrukturës IT”

Kohëzgjatja e kontratës: 1 (një) muaj kalendarik duke nisur nga dita e lidhjes së kontratës.

Fondi limit: 37.290.000 (tridhjetë e shtatë milion e dyqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa tvsh

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 21/08/2019, ora 11.00

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 31 datë 05 gusht 2019.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Soft & Solution” sh.p.k NUIS L11328009F

Vlera e ofertës pa TVSH– 36,736,696 (tridhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë

Vlera e ofertës me tvsh– 44,084,035 (dyzetë e katër milion e tetëdhjetë e katër mijë e tridhjetë e pesë) lekë

2. Operatori ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k NUIS J61817047D

Vlera e ofertës pa TVSH– 35.977.770 (tridhjetë e pesë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) lekë

Vlera e ofertës me tvsh– 43.173.324 (dyzetë e tre milion e njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzetë e katër) lekë.

Është s’kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **Operatori ekonomik “Soft & Solution” sh.p.k**

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar) si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik **“Soft & Solution” sh.p.**, nga ku rezultoi se:

1. Operatori ekonomik “Soft & Solution” sh.p.k, nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit, pasi në Deklaratën mbi Përmbushjen e Kriereve të Përgjithshme, sipas Shtojcës 8 të DST-së, të paraqitur në spe, nuk përputhet objekti i prokurimit me objektin e kësaj procedure, objekt vlerësimi.

2. Operatori ekonomik “Soft & Solution” sh.p.k, nuk plotëson “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ pika b, ç, d, dh dhe e” pasi :

2.1 Në Deklaratën (referuar pikës b), *për paraqitje oferte të pavarur sipas shtojcës 2/1*, të paraqitur në spe, nuk përputhet objekti i prokurimit me objektin e kësaj procedure, objekt vlerësimi.

2.2 Në Deklaratën (referuar pikës ç), *mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6* të paraqitur në spe, nuk përputhet objekti i prokurimit me objektin e kësaj procedure, objekt vlerësimi.

2.3 Në Deklaratën (referuar pikës d), *mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 7*, të paraqitur në spe, nuk përputhet objekti i prokurimit me objektin e kësaj procedure, objekt vlerësimi .

2.4 Në Deklaratën (referuar pikës dh), *mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojcës 8/1*, të paraqitur në spe, nuk përputhet objekti i prokurimit me objektin e kësaj procedure, objekt vlerësimi .

2.5 Operatori ekonomik “Soft & Solution” sh.p.k, nuk ka paraqitur *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri*, duke mos përmbushur kështu kërkesën sipas “pikës e” të Kriereve të Veçanta të Kualifikimit .

3. Operatori ekonomik, nuk plotëson “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik/pika 2.3.1”, pasi referuar kontratës së paraqitur për furnizime të ngjashme me nr. 17238/13 Prot., datë 15.01.2018, me objekt “Blerje pajisje të teknologjisë se informacionit dhe komunikimit TIK për nevojat e Bashkisë dhe Institucioneve të Varësisë së Bashkisë (Blerje e përqendruar)” me vlerë 5.698.700 lekë pa TVSH, nënshkruar ndërmjet operatorit “Soft & Solution” sh.p.k dhe autoritetit kontraktor Bashkia Shkodër, nuk përmbushet vlera e kërkuar e furnizimeve të ngjashme prej 14.916.000 (katërmëdhjetë milion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion referuar çdonjëres prej pikave të mëposhtme të DST:

2.3.2 Sipas së cilës *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizimin e Prodhuesit ose distributorit të autorizuar për rajonin e Shqipërisë për të gjithë zërat e ofertuara për këtë procedurë prokurimi. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vertetohet lidhja midis distributorit dhe prodhuesit.”*.

Sipas së cilës *“Operatori ekonomik duhet të zotërojë status partneriteti të paktën të nivelit Gold (ose ekuivalent) për pajisjet e prodhuesit/ prodhuesve të infrastrukturës (Storage, Server, Switch) të ofertuara. Për të provuar këtë kërkesë duhet të paraqitet çertifikata apo deklarimi zyrtar në faqen web”*.

Sipas së cilës *“Operatori ekonomik duhet të deklarojë stafin teknik përgjegjës për mallrat dhe*

instalimin sipas specifikimeve teknike, për të garantuar suportin dhe garancine e tyre pergjate periudhes se parashikuar. Operatori ekonomik duhet të disponoje te pakten prej 5 (pesë) punonjës, të cilët duhet të jenë të diplomuar në Informatikë, Elektronikë, Telekomunikacion, Teknologji Informacioni, ose Matematike Informatike.....”.

Sipas së cilës “Për secilën pajisje të kërkuar sipas specifikimeve teknike, të jepet informacion i detajuar me të gjithë numrat e pjesëve të të gjithë komponentëve dhe sasi të tyre të konfigurimit të propozuar. Operatori ekonomik duhet që në ofertën teknike të paraqesë markën, modelin dhe katalogë/broshurë për mallin që oferton.....”

Për sa më sipër, Operatori Ekonomik shoqëria “Soft & Solution” sh.p.k s’kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor, teknik dhe ekonomik kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, njëzëri vendosi, të **shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k**, me adresë: Bulevardi Zhan D'ark, Nd.32, Hyrja 16, Kati 2, Ap.1, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 35.977.770 (tridhjetë e pesë milion e nëntëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) lekë pa tvsh dhe 43.173.324 (dyzetë e tre milion e njëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzetë e katër) lekë me TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 06.09.2019.

Ankesa: Nuk është paraqitur asnjë ankesë për klasifikimin përfundimtar.